



Deklaratat e përfaqësuesve më të lartë të vendeve post-jugosllave për pajtim dhe bashkëpunim rajonal, të dhënë në vitin 2016.

Perspektiva e Kosovës

- **Deklaratat e Presidentes Atifete Jahjaga nga 1 janari 2016, deri në zgjedhjen e Hashim Thaçit president, më 26 shkurt 2016**

Më 16 shkurt 2016, **zonja Atifete Jahjaga priti presidenten së Republikës së Maltës, Shkëlqesinë e Saj, zonjën Marie Louise Coleiro Preca**, e cila qëndroi për vizitë zyrtare shtetërore në Kosovë, me ftesë të Presidentes Jahjaga, e që kishte për qëllim intensifikimin e bashkëpunimit në fusha të interesit të përbashkët, në veçanti në fushën e zhvillimit ekonomik dhe të investimeve, si dhe për përkrahjen që Malta mund t'i japë Kosovës në proceset e integritimit në BE dhe në organizatat ndërkombëtare. Në fjalimin e saj znj. Jahjaga deklaroi: “Rruga evropiane është rruga e pashmangshme e gjithë vendeve të rajonit të Ballkanit, që duhet të mësohen me realitetin e ri të krijuar, duke ndërtuar marrëdhënie të mira fqinjësore, që çon *drejt një pajtimi të madh në Ballkan*.”¹

Në fjalimin e tij inaugurues, me 08 prill 2016, Presidenti i sapo zgjedhur i Kosovës, Hashim Thaçi, ka përmendur edhe dialogun e dyfishtë në Kosovë me komunitetet jo-shumicë dhe me Serbinë. “Ne duhet të vazhdojmë rrugëtimin tonë evropian dhe dialogun me Serbinë, sepse qytetarët na kanë obliguar ta anëtarësojmë Kosovën sa më shpejtë në BE dhe NATO. Ky është një obligim dhe detyrim nacional që edhe në momentet më të vështira, edhe në bisedat më të rënda dhe në çastet më provokuese, mos t'i dorëzohemi dëshpërimit, mos të dorëzohemi para urrejtjes. Ne do të ndërtojmë fqinjësinë e mirë. Dialogu nuk ka alternativë. *Kosova dhe Serbia duhet të kalojnë nga faza e normalizimit të marrëdhënieve në procesin e pajtimit në mes të dy shteteve dhe dy popujve. Jam i bindur se pajtimi do të ndodh.*”²

Kurse sa i përket bashkëpunimit ai deklaroi: “*Marrëveshja e Brukselit nuk është një ishull. Ajo solli relaksim raportesh politike në gjithë rajonin tonë. Sot Ballkani dhe gjithë rajoni është ndryshe. Secili komunikon me secilin. Së bashku me Planin e Ahtisarit dhe Marrëveshjen e Rambujesë – ajo është edhe një pikë referuese e historisë sonë moderne, e arkitekturës së paqes në Ballkan.*”³

Thaçi për mediet franceze: Jam president i vendit që ka dhënë “Nënë Terezën”

¹ Presidentja Atifete Jahjaga priti presidenten e Maltës, Marie Louise Coleiro Preca, Presidency web, 16.02.2016:

<http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,4236#.V8m2P1R97IU>

² Fjalimi i Presidentit Thaçi në ceremoninë e inaugurimit, Presidency web, 08.04.2016:

<http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,4327#.V8mz8VR97IU>

³ Ibid.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, intervistën e parë për mediet ndërkombëtare ia ka dhënë gazetarit të famshëm francez, Harold Hyman. Gjatë intervistës ai është pyetur edhe për procesin e normalizimit të marrëdhënieve dhe pajtimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Sipas tij, modeli gjermano-francez do të jetë vështirë i implementueshëm. “Shpesh merret parasysh nga ndërkombëtarët e kaluara franko-gjermane dhe pastaj edhe pajtimi i tyre, por, për fat të keq, as kosovarët as serbët nuk kanë mendje të ndritura si Balzak apo Gyte. Unë vijë nga vendi që ka dhënë një personalitet si Nëna Terezë, e cila ka sjellë vetëm vlera, dashuri, respekt, mirëkuptim”.⁴

Gjatë vizitës së zëvendëspresidentit të SHBA-së, Joe Biden, në Kosovë, më 17 gusht, Thaçi i ka premtuar Biden se pajtimi mes Kosovës dhe Serbisë do të ndodhë. “Për më tepër ne kemi shënuar hapa të rëndësishme në normalizimin mes Kosovës dhe Serbisë. Ne kemi arritur marrëveshjen historike të prillit të vitit 2012. Ne e kemi për detyrë t’i japim dinamikë të re dialogut dhe sa më shpejt të vie pajtimi mes dy shteteve të pavarur. *Jam i sigurt që pajtimi do të ndodhë*”, ka theksuar Thaçi.⁵

Presidenti Thaci: Dialogu nuk ka alternativë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në një intervistë të publikuar më 26 prill 2016, në të përditshmen austriake “Tiroler Tageszeitung”, ka folur për të arriturat e Kosovës, prioritetet e tij, dialogun me Serbinë dhe Gjykatën Speciale. i është pyetur edhe për procesin e dialogut dhe normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, për të cilën presidenti Thaçi ka pohuar se normalizimi i marrëdhënieve, dialogu dhe pajtimi nuk kanë alternativë. “*Si në Kosovë, ashtu edhe në Serbi, kryeministrit të cilët udhëhoqën dialogun fituan sërish në zgjedhjet e përgjithshme, duke dëshmuar se popullsia mbështet procesin e dialogut*”, ka shtuar Thaçi. Ai ka ritheksuar se procesi i dialogut duhet të bëhet më dinamik, në mënyrë që të arrihet një marrëveshje kornizë për pajtim, por dinamikë, sipas tij, duhet të ketë edhe në zbatimin e marrëveshjeve për të cilat ka dakordim deri më tani.⁶

Në një intervistë për “**Zërin e Amerikës**”, më 15 prill, Presidenti Thaci ndër të tjera u pyet edhe për bisedimet me Serbinë, në të cilën u përgjigj: “*Dialogu për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë ka pasur rezultate pozitive edhe për Kosovën, Serbinë dhe rajonin.(...) Do të punohet maksimalisht që të zbatohen të gjitha marrëveshjet. Unë besoj fuqishëm se nga procesi i normalizimit të marrëdhënieve mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë duhet të kalojmë në fazën e pajtimit. Unë besoj në pajtimin në mes të kombeve dhe shteteve tona ndërsa sa i përket rajonit ka pasur reflektime. Ju mund të imagjinoni se nuk do të ndodhte asnjë vizitë e kryeministrit të Shqipërisë në Beograd pas gjashtë dekadave të raporteve të ngrira sepse e ardhmja e relacioneve shqiptare dhe serbe kalon përmes Prishtinës. Nëse Prishtina ka raporte korrekte me Beogradin atëherë reflektohet në të gjithë rajonin kudo që jetojnë shqiptarët, ndërsa nëse ato tensione janë në mes Prishtinës dhe Beogradit reflektohen në kuptimin negativ dhe gjithashtu pastaj edhe vizita e kryeministrit të Serbisë në Tiranë, por edhe në relacionet tjera që ka Kosova të shkëlqyer me vendet tjera të rajonit.*”⁷

Në shënimi i Ditës së të Pagjeturve, 27 prill 2016, Presidenti Thaci, vizitoi fshatin Meje të Gjakovës, ku tha se për të punuar dhe për të ndërtuar një të ardhme në të cilën të gjithë do të jenë të barabartë, duhet të përballemi edhe me të kaluarën. “Duhet drejtësi për viktimat e luftës. Drejtësi për të gjitha viktimat, pa dallim etnie”, tha ai. Presidenti Thaçi ka theksuar se Kosova është treguar e vullnetshme që të bashkëpunojë me të gjithë, të marrë mbi vete çdo obligim, që të sqarohen dhe dënohen krimet e kryera, nga kushdo dhe kudo. Por, “kjo duhet të kërkohet nga të gjithë në rajonin tonë”, ka thënë Thaçi, duke shtuar se përfshirja e shtetit të Serbisë në krimet e kryera në Kosovë është dëshmuar. “Serbia ka kryer gjenocid në Kosovë, por populli ynë është i

⁴ Interview exclusive de Hashim Thaçi, nouveau président du Kosovo : « La Serbie et le Kosovo, ce n'est pas comme la France et l'Allemagne à une époque », Opinion Internationale, 14.04.2016: https://www.opinion-internationale.com/2016/04/14/interview-exclusive-de-hashim-thaci-nouveau-president-du-kosovo-la-serbie-et-le-kosovo-ce-nest-pas-comme-la-france-et-lallemagne-a-une-epoque_42832.html

⁵ Thaçi: Pajtimi mes Kosovës dhe Serbisë do të ndodhë, Gazeta Express, 17.08.2016: http://www.gazetaexpress.com/lajme/thaci-pajtimi-mes-kosoves-dhe-serbise-do-te-ndodhe-240708/?utm_source=website&utm_medium=RA&utm_content=Hashim%20Thaci,Joe%20Biden,Serbia&utm_campaign=InsideArticle&past_aid=

⁶ Hashim Thaci: „Es gibt keine Alternative zum Dialog“, Tiroler Tageszeitung Online, 26.04.2016: <http://www.tt.com/politik/11421638-91/hashim-thaci-es-gibt-keine-alternative-zum-dialog.csp>

⁷ Intervistë me Presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, Zeri i Amerikës, 15.04.2016: <http://www.zeriamerikes.com/a/kosovo-thaci-interview/3287144.html>

vendosur që të shikojë nga e ardhmja më e mirë për gjeneratat e reja”, ka thënë presidenti Thaçi. *Ai ka thënë se duhet të punohet më shumë për të ardhmen e sigurt evropiane, për drejtësi për të gjitha viktimat e luftës dhe për pajtim.*⁸

Me rastin e 17 vjetorit nga rënia e Ilaz Kodrës në krye të Brigadës 114, njërit prej komandantëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, presidenti Thaçi në fjalimin e tij tha se: *“miqësia me Amerikën të ruhet si sytë e ballit dhe që së bashku të integrohemi në NATO dhe BE; Kjo do të kërkojë sakrificë të reja politike, dialog të singertë, paqe dhe pajtim.”*

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka marr pjesë në **samitin e Procesit të Bashkëpunimit në Evropën Juglindore (SEECP) në Sofje të Bullgarisë**, e cila sivjet ishte kryesuese e këtij procesi. Në fund të fjalimit të tij, presidenti Thaçi ka thënë se udhërrëfyesin për të ardhmen tonë më të mirë e kemi, kurse forumet si SEECP janë mekanizma për të vlerësuar dhe elaboruar më shumë këtë udhërrëfyes. *“Është detyrë e jona si liderë politikë të japim shembull duke ndërtuar miqësi, bashkëpunim, pajtim dhe besim”*, ka thënë ai.

Gjatë takimit me nënsekretaren e Shtetit të SHBA-së, Victoria Nuland, Presidenti Thaçi e njoftoi për zhvillimet e fundit në Kosovë dhe për prioritetet e tij si president i vendit. Në vazhdim ai tha se Kosova promovon marrëdhëniet e mira fqinjësore, duke përfshirë edhe Serbinë. *“Të dyja palët duhet të implementojnë të gjitha marrëveshjet e arritura deri tani. Është koha për një kualitet të ri në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, që do të sjell pajtim dhe marrëdhënie fqinjësie më të mira dhe më bashkëpunuese”*, shtoi presidenti Thaçi.⁹

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, më 20 korrik 2016, ka vendosur kurore lulesh në **memorialin e 14 qytetarëve serbë të vrarë menjëherë pas luftës, 17 vite më parë, në fshatin Grackë të Lipjanit**. Ai u shpreh se lutet me dhimbje dhe shpreh keqardhje për të gjitha viktimat e vrarë menjëherë pas luftës, 17 vite më parë, në këtë fshat. Këtë akt kriminal, presidenti Thaçi e ka quajtur veprim jo vetëm kundër viktimave që ishin duke punuar në arë, por edhe akt kundër lirisë së Kosovës dhe të ardhmes së saj demokratike. *“Sot lutem me dhimbje dhe shpreh edhe një herë keqardhje për të gjitha viktimat gjatë dhe pas luftës, të të gjitha komuniteteve. Çdo krim duhet të zbardhet dhe të ndëshkohet. Krimi është krim kundër kujtdo qoftë të jetë bërë apo nga kushdo qoftë që është kryer”*, ka thënë presidenti Thaçi. Gjithashtu, ai ka thënë se duhet të zbardhet njëherë e përgjithmonë fati i të gjithë të zhdukurve, qofshin shqiptarë, serbë, romë apo çfarëdo komuniteti tjetër. *“Të gjithë kemi përgjegjësi të punojmë në këtë drejtim. Kemi përgjegjësi para familjeve të tyre dhe të ardhmes së fëmijëve tonë. Ne duhet ta ndihmojmë njeri-tjetrin. Dhimbja e çdo nëne është e njëjtë për humbjen e familjarëve të vet”, është shprehur presidenti Thaçi. Ai ka thënë se sot, kur po punojmë për të ndërtuar paqe, për pajtim dhe bashkëpunim në mes të popujve të rajonit tonë është e rëndësishme të theksojmë se për pajtim të singertë është e nevojshme drejtësia. “Si Kosovë, kemi arritur shumë në këto 17 vite që nga lufta. Kemi filluar të ndëtojmë ura të komunikimit dhe të bashkëpunimit. Në një ditë të afërt, kjo do të sjellë besim dhe pajtim mes komuniteteve dhe popujve”*, ka thënë presidenti Thaçi. Ai ka theksuar se vetëm duke ngadhënjyer drejtësia do të ndodhë pajtimi, e pajtimi do të ndodhë në një të ardhme të afërt, sepse ka vullnet për këtë. *“Vetëm pajtimi dhe bashkëpunimi e bën Kosovën dhe rajonin vërtetë evropian”*, ka përfunduar presidenti Thaçi.¹⁰

15 gusht 2016 – Një nderim tjetër Presidenti Hashim Thaçi, u ka bërë gjithashtu të rinjve të vrarë në **Gorazhdec të Pejës** në një sulm ende të pazbuluar, më 13 gusht 2003, dhe ka bërë thirrje që autorët e krimit të dalin para drejtësisë. *“Sot vura kurorë lulesh në këtë memorial për të përkujtuar sulmin kriminal kundër të rinjve të fshatit Gorazhdec, 14 vite më parë, në të cilin u vranë dy të rinj e u plagosën katër të tjerë”*, u shpreh presidenti Thaçi para gazetarëve të mbledhur dhe shtoi se *“e drejta për jetë është e drejtë fundamentale për të gjithë”*. *“E tillë do të duhej të ishte edhe për rreth 400 fëmijë shqiptarë nën moshën 15 vjeç që gjatë luftës u vranë nga shteti i Serbisë”*, ka thënë presidenti Thaçi, cili theksoi se *“ndërkaq, këta fëmijë këtu u vranë nga dora kriminale, e jo nga shteti”*. Më pas përsëriti fjalët e thëna në Grackë të Vjetër: *“Sot, kur po punojmë për të ndërtuar paqe, pajtim dhe bashkëpunim mes popujve të rajonit, është e rëndësishme të theksojmë se për pajtim të singertë është e domosdoshme drejtësia.*

⁸Thaçi kërkon më shumë angazhim për zbardhjen e fatit të të pagjeturve, Telegrafi, 27.04.2016:

<http://www.telegrafi.com/thaci-kerkon-shume-angazhim-per-zbardhjen-e-fatit-te-te-pagjeturve/>

⁹Thaçi-Nuland: Demarkacioni duhet të miratohet sa më parë, Koha.net, 10.07.2016:

<http://koha.net/?id=27&l=122874>

¹⁰Presidenti Thaçi nderon 14 serbët e vrarë në Grackë të Lipjanit para 17 vjetësh, Koha.net, 20.07.2016:

<http://koha.net/?id=&l=124661>

Pajtimi në mes shqiptarëve dhe serbëve është i mundur dhe do të ndodhë. “Ky hap do të thotë paqe për rajonin”, përfundoi Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi.¹¹

Fjalimi i Presidentit Thaçi në ceremoninë e përrurimit të rrugës “Beau Biden” më 17 gusht, kishte të bënte edhe me pajtimin; duke u shprehur se “*Nëse plotësisht normalizojmë marrëdhëniet me Serbinë, ne i japim kuptim pages - pajtimin në mes popujve dhe vendeve tona.*” Duke vlerësuar se nga kjo të gjithë do të jemi fitues.¹²

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, më 19 gusht, priti kryetarët e odave ekonomike të Kosovë dhe të Serbisë, Safet Gërxhaliu dhe Marko Çadezh, të cilët e njoftuan presidentin Thaçi për projektet e odave ekonomike të shteteve të rajonit rajonit për të thelluar bashkëpunimin ekonomik në mes vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kryetari i Odës Ekonomike të Serbisë, Çadezh, e informoi presidentin Thaçi për punën e Forumit të Investimeve të Odave të Ballkanit Perëndimor për të kontribuar në “Procesin e Berlinit” me projekte për bashkëpunim rajonal. “Kemi bërë bashkë ekspertë të ndryshëm që të japin zgjidhje për problemet e ndryshme praktike, siç është telekomunikimi, shërbimet postare”, u shpreh Çadezh, i cili shtoi se po punohet në njësimin e certifikatave të prodhimeve të shteteve të Ballkanit Perëndimor për të lehtësuar qarkullimin e mallrave. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Gërxhaliu, u shpreh se në thelb të kësaj nisme është angazhimi që nëpërmjet dialogut të hiqen barrierat e bashkëpunimit në mes ekonomive të Ballkanit Perëndimor e më gjerë. “Kështu do të përmirësojmë reputacionin e Kosovës por edhe të tërë rajonit, duke i bërë vendet tona më atraktive për investitorët e huaj”, ka thënë Gërxhaliu, duke sqaruar se kompanitë e mëdha botërore e shohin tërë rajonin si një treg të vetëm. Presidenti Thaçi e mirëpriti punën e odave ekonomike të rajonit dhe u shpreh se “zakonisht, ekonomia ecën më shpejt se politika”. “Është koha për një faqe të re në bashkëpunimin e tërë rajonit”, theksoi presidenti Thaçi. “Do të keni gjithmonë përkrahjen tonë për projektet tuaja për të promovuar bashkëpunimin”, ka thënë presidenti Thaçi, duke përfunduar se “kemi shumë sfida, por e rëndësishme është që të mos ndalemi”.¹³

Më 28 gusht 2016, **Presidenti Thaçi, ka dënuar skenat që janë parë të dielën (28 gusht) në fshatin Mushtisht** dhe ka bërë thirrje që të respektohet e drejta e secilit që të kthehet në pronat e veta. “Janë krejtësisht të panevojshme dhe të papranueshme skenat nga fshati Mushtisht”, është shprehur presidenti Thaçi, i cili ka shtuar se “këto veprime nuk janë as në interes të Kosovës dhe të qytetarëve të saj”. Ai ka përsëritur se është e drejtë e secilit që të kthehet në pronën e tij dhe në vendin e tij të origjinës. “Çështja e të zhdukurve, e të zhvendosurve, e pronave të uzurpuara janë plagë të hapura nga lufta. Duhet t’i mbyllim sa më parë këto plagë dhe të kthehemi nga e ardhmja”, ka thënë presidenti Thaçi, i cili theksoi se *e ardhmja është në paqe, dialog dhe bashkëpunim*.

Duke shtuar se dhuna nuk ka vend në Kosovën e re, presidenti Thaçi përfundoi se drejtësia do të merret me të gjithë ata që kanë kryer krime në të kaluarën, meqë “drejtësia është kusht për pajtim të sinqertë dhe për ndërtimin e Kosovës multietnike”.¹⁴

Këto reagime Thaçi i bëri pasi që qindra qytetarë të fshatit Mushtisht të komunës së Suharekës nuk i kanë lejuar disa pelegrinë serbë që të bëjnë homazhe në Kishën e tyre dhe t’i vizitojnë pronat në këtë fshat. Qytetarët ishin barrikaduar në rrugë, ndërsa janë përleshur edhe me Policinë e Kosovës e cila ka përdorur edhe gazin lotsjellës. Menjëherë pasi rruga është bllokuar në Mushtisht ka shkuar Policia e Kosovës, e cila ka përdorur gazin lotsjellës për ta zhblokuar rrugën. Autoritete e rendit kanë arritur që të lirojnë rrugën e bllokuar, mirëpo pjesëtarët e komunitetit serb, të cilët kanë pritur disa orë në tre autobusë, janë kthyer dhe nuk kanë hyrë në fshat.

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Zhdukjeve të Dhunshme, 31 gusht, presidenti Thaçi, ka theksuar se të pagjeturit mbesin një nga plagët më të rënda që ka lënë lufta në Kosovë, ndërsa zgjidhja e fatit të të pagjeturve një nga detyrat më urgjente dhe më të rëndësishme për të gjithë. “Lufta ka lënë shumë plagë, por ajo e të pagjeturve është ndër më të rëndat”, ka thënë presidenti Thaçi, i cili shtoi se kjo çështje “rëndon familjet e të të pagjeturve por edhe tërë shoqërinë, marrëdhëniet mes komuniteteve por edhe gjasat për një të ardhme më të mirë”. “Është nevojë urgjente, detyrë humanitare, obligim i të gjithëve që sa më parë të zbardhet fati i të gjithë të pagjeturve, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike”, tha presidenti Thaçi. I pari i vendit theksoi se

¹¹ Thaçi në Gorazhdec: Askush nuk do të mund të vrasë të ardhmen, RTK Live, 15.08.2016: <http://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=92375>

¹² Fjalimi i plotë i Thaçit në përrurimin e rrugës Beau Biden, Gazeta Express, 17.08.2016: <http://www.gazetaexpress.com/lajme/fjalimi-i-plote-i-thacit-ne-perurimin-e-rruges-beau-biden-240903/>

¹³ Odat Ekonomike të Kosovës e Serbisë: Të ndërtohet autostrada Prishtinë-Nish, Lajmi.net, 20.08.2016: <http://lajmi.net/odat-ekonomike-te-kosoves-e-serbise-te-ndertohet-autostrada-prishtine-nish/>

¹⁴ Thaçi i quan të papranueshme skenat në Mushtisht, fton të respektohet e drejta për kthim, Koha.net, 28.08.2016: <http://koha.net/?id=27&l=130172>

nuk kalon ditë që nuk i kujtojmë të pagjeturit. “Na shikojnë nga fotot e varura në rrethojën e Kuvendit të Kosovës. Na thërrasin familjet. Na i kujtojnë memorialët që i shohim rrugëve të Kosovës. Ndërkaq, në ditët si 30 gushti, zotohemi që gjithmonë, pandërprerë, do të kërkojmë dhe do të këmbëngulim që sa më parë të zbardhet fati i secilit qytetar të Kosovës, në mënyrë që familjet e të pagjeturve të gjejnë paqen e tyre”. Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, përfundoi se “*janë mu këto dhimbje që i ka shkaktuar lufta motivi ynë që të punojmë që të mos lejojmë që të përsëritet lufta por gjithmonë të ketë paqe, pajtim dhe bashkëpunim mes të gjitha komuniteteve*”.¹⁵

Presidenti Hashim Thaçi, gjatë pjesëmarrjes në ceremoninë e ndërrimit të komandës së KFOR-it, nga gjenerali Guglielmo Luigi Miglietta tek gjenerali Giovanni Fungo, më 1 shtator 2016, falënderoi komandantin e deritashëm dhe tërë KFOR-in për punën dhe angazhimin e tyre në ruajtjen dhe forcimin e paqes në Kosovë dhe në rajon. Ai poashtu theksoi vlerësoi komunikimin e mirë me qytetarët. “*Nëpërmjet këtij komunikimi jepen më fortë se në çfarëdo mënyre tjetër mesazhet e paqes, të pajtimit, të bashkëpunimit, mesazhe që tregojnë se të gjithë kemi përgjegjësi për të ndërtuar jetë më të mirë në rajon*. Prandaj, për angazhimin e tij, i themi një faleminderit të madhe dhe të sinqertë”, ka thënë presidenti Thaçi.¹⁶

Me 3 shtator, Presidenti Thaçi, ka dënuar dëmtimin e një dite më parë (2.09.2016) të pllakës përkujtimore në Grackë të Vjetër të Lipjanit, ku më parë kishte vendosur lule. Është i dënueshëm dëmtimi i pllakës përkujtimore në Grackë të Vjetër”, është shprehur presidenti Thaçi dhe ka shtuar se “çdokush që ia do të mirën Kosovës e dënon këtë akt të papranueshëm”. Ai ka thënë se incidentet si ky cenojnë marrëdhëniet e mira ndëretnike që po promovon Kosova, shkaktojnë frikë, zemërim e urrejtje dhe për këto nuk ka nevojë askush në Kosovë. “*Duke promovuar dialogun, pajtimin, bashkëpunimin, luftimin e çdo ekstremizmi, jemi pranuar si pjesë e bashkësisë ndërkombëtare*. Vetëm duke i promovuar këto vlera e ruajmë vendin që e meritojmë në bashkësinë ndërkombëtare”, ka shtuar presidenti Thaçi. Ai ka theksuar se Kosova nuk mund të lejojë të pësojë për shkak të një pakice ekstremiste. “Qytetarët e Kosovës, shumica dërmuese, të gjitha komunitetet, janë për paqe, për stabilitet, për zhvillim, për jetë më të mirë për të gjithë. Vetëm një pakicë fare e vogël ende ushqen ide ekstremiste dhe përjashtim, frikë e urrejtje. Nuk do të lejojmë që kjo pakicë të cenojë ambiciet dhe aspiratat e shumicës së Kosovës”, ka përfunduar presidenti Thaçi.¹⁷

- **Deklaratat e Kryeministrit Isa Mustafa nga 1 janari 2016, mbi pajtimin dhe bashkëpunimin rajonal**

Nuk ka.

- **Deklaratat Ministrit të Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj nga 1 janari 2016, mbi pajtimin dhe bashkëpunimin rajonal**

Nuk ka.

Përgatitur: Teuta Hoxha

¹⁵ Presidenti Thaçi: Të pagjeturit, plaga më rëndë që na la lufta, Koha.net, 29.08.2016: <http://koha.net/?id=27&l=130247>

¹⁶ KFOR-I jo vetëm që ruan paqen, por edhe ndërton atë, Kosovalive360, 01.09.2016: <http://www.kosovalive360.com/thaci-kfor-i-jo-vetem-ge-ruan-paqen-por-edhe-nderton-ate.html>

¹⁷ Thaçi: Kosova nuk mund të lejohet të pësojë për shkak të një pakice ekstremiste, IndeksOnline, 03.09.2016: <http://indeksonline.net/lajmet/thaci-kosova-nuk-mund-te-lejohet-te-pesoje-per-shkak-te-nje-pakice-ekstremiste-14195/>